



Pranuar / Dorezuar Përmblenë/Prodato Received/Delivery		10.12.2021		1 viti god year	
Organ./Mjesia Organ./Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKM/SHUK	6018/2021		115		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.889/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.889/2021 të datës 27.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Bulevardi "Adem Jashari", Vushtrri, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.889/2021 e datës 27.10.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.51/2021 i datës 30.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi kandidat për pranim në Shërbim Civil, me datë 27.10.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5182/2021 të regjistruar me numër A.nr.889/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.51/2021 të datës 30.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.11.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli, me datë 24.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5182/2021 të regjistruar me numër A.nr.889/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 30.09.2021 me numër të protokollit 01/1582 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Certifikatën e datës 10.06.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.11.2021 me numër të protokollit 5227/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 15.11.2021 me numër të protokollit 5438/2021; Emalin e datës 23.11.2021 me numër të protokollit 5620/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 24.11.2021 me numër të protokollit 5642/2021; Vlerësimin e testit me shkrim i datës 13.08.2021 dhe testit me gojë të datës 13.08.2021 si dhe Testin me shkrim të kandidatit Konkursin e jashtëm të datës 20.05.2021 me numër të protokollit 03/970; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 20.08.2021 me numër të protokollit 03/1406; Deklaratat për mosekzekutimin e konfliktit të interesave të datës 23.07.2021 të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit; Raportin e rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 19.08.2021; Propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar të datës 20.08.2021; Përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushte të datës 23.07.2021; Përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj të datës 13,14,15,16.08.2021; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Renditjen përfundimtare të kandidateve; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Aktin e emërimit të datës 18.09.2018 me numër të protokollit 03/599; Aktin e Emërimit të datës 22.09.2014 me numër të protokollit 03/295; Aktin e Emërimit të datës 27.09.2017 me numër të protokollit 126/2017; Aktin e Emërimit të datës 07.04.2014 me numër të protokollit 03/183; Aktin e Emërimit të datës 29.04.2020 me numër të protokollit 03/376; Vlerësimin e testit me shkrim i datës 30.07.2021 dhe testit me gojë të datës 15.08.2021 si dhe testi me shkrim i ankuesit Kërkesën për punësim të datës 28.05.2021 e parashtruar nga ankuesi; Dokumenti i identifikimit të ankuesit; Vërtetimin e datës 28.03.2019; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës të datës 05.05.2021; Kontratën e punës për kohe të pacaktuar; Kontratën për shërbime në mes të IKD-se dhe ankuesit; Kontratën për punë praktike dhe detyra specifike; Diplomën e universitetit të datës 19.11.2018 me të cilin ankuesi mori titullin jurist i diplomuar; Vlerësimi i testit me shkrim i datës 30.07.2021 me i testit me gojë si dhe testi me shkrim i kandidatës Kërkesën për punësim të datës 24.05.2021 me numër 08/2021; Diplomën e universitetit të datës 29.06.2018 me të cilën kandidatja mori titullin Juriste e diplomuar; Certifikatën e datës 16.03.2020; Certifikatën e datës 24.11.2020 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga Gjykata; Dokumentin e identifikimit të kandidatës Letren rekomanduese; Referencën e datës 10.03.2020; Certifikatën e datës 22.10.2017; Certifikatën e datës 04.05.2018; Testin me shkrim të datës 30.07.2021 të kandidatës Vlerësimin e testit me shkrim të datës 30.07.2021 dhe testit me gojë të datës 15.08.2021 të kandidatës Kërkesën e datës 03.06.2021 të kandidatës Referencën e datës 03.06.2021; Diplomën Universitare të datës 13.02.2020 me të cilin kandidatja mori titullin Juriste e diplomuar; Rekomandimin e datës 31.05.2021; Kontratën e Punës të datës 08.11.2019; Vërtetimin e datës 22.04.2020; Aktin e emërimit të datës 10.06.2020; Vërtetimin e datës 24.05.2021; Dokumentin e identifikimit të kandidatës Certifikatën e datës 29-30.10-2016; Certifikatën e datës 27-28.10.2017; Certifikatën e muajit dhjetor të vitit 2015; Certifikatën e datës 27.10.2018; Certifikatën e datës 30.11.2018; Certifikatën e datës 17.12.2018; Certifikatën e datës 10.06.2021; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 30.07.2021 dhe testit me gojë të datës 13.08.2021 të kandidatës Testin me shkrim të datës 30.07.2021 i kandidatës Kërkesën për punësim të datës 28.05.2021 të kandidatës Dokumentin e identifikimit të kandidatës Pasqyrën e llogarisë së kandidatës

Maxherra; Kontratën e punës të datës 02.03.2020; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 02.09.2020; Kontratën e punës të datës 01.05.2019; Referencën e datës 25.01.2021; Referencën e datës 27.05.2021; Letrën e rekomandimit të datës 26.05.2021; Vërtetimin e datës 13.04.2018 me numër te protokollit 179/2018; Certifikatën për vitin 2018/2019; Certifikatën lidhur me programin legal për të rinjtë: Certifikatën e datës 11.10.2018; Certifikatën e datës 05.05.2018; Certifikatën për periudhën kohore 14.01.2019 deri me 19.04.2019; Certifikatën e datës 06.04.2018; Certifikatën për periudhën kohore Dhjetor 2018; Certifikatën e datës 09.04.2015; Certifikatën e vitit 2018; Certifikatën lidhur me trajnimin për periudhën kohore 17.07.2018 deri me 23.07.2018; Mirënjohjen për kandidaten e vitit 2018; Certifikatën e muajit Dhjetor viti 2015; Certifikatën e datës 05.04.2014; Certifikatën e datës 16,17.05.2015; Certifikatën e datës 17.12.2018; Diplomën universitare te datës 28.06.2019 me te cilën kandidatja me te cilën mori titullin juriste e diplomuar; Kërkesën për punësim të datës 25.05.2021 te kandidatit Kontratën e punës të datës 01.09.2020; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 30.07.2021 dhe testit me gojë të datës 13.08.2021 te kandidatit Testin me shkrim të datës 30.07.2021 te kandidatit Vërtetimin e datës 06.07.2020 me numër 649/2020; Marrëveshjen për angazhimin e masës në masën aktive te tregut te punës të datës 18.06.2018 me numër 6840; Marrëveshjen për angazhimin ne masën aktive te tregut te punës të datës 06.12.2018 me numër 480; Diplomën për kryerjen e shkollës se mesme te larte te Gjinnazit; Diplomën universitare të datës 28.06.2018 me te cilin kandidati mori titullin jurist i diplomuar; Diplomën universitare të datës 24.09.2020 te kandidatit me të cilën mori titullin master në të drejtën civile dhe pronësore; Certifikatën e datës 20.05.2021 nga evidenca e personave kundër te cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga Gjykata; Dokumentin e identifikimit të kandidatit Marrëveshjen e datës 18.06.2018 për angazhimin në masën aktive të tregut; Marrëveshjen e datës 03.12.2018 për Angazhimin ne masën aktive të tregut të punës; Emalin e datës 26.11.2021; Listën e kandidateve që ju kanë nënshtruar testit me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, për katër (4) pozita, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Organi i punësimit me datë 20.08.2021, ka publikuar njoftimin lidhur përzgjedhjen përfundimtar të kandidateve për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, sipas të cilit njoftim është poentuar si kandidatja e parë me gjithsej 437.75 pikë, si kandidatja e dytë me gjithsej 404.5 pikë, kandidati i tretë me gjithsej 394.25 pikë dhe si kandidatja e katër me gjithsej 392.5 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidateve, ankuesi është poentuar me gjithsej 297.75 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me Njoftimin e datës 20.08.2021, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare, me datë 09.09.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.nr.51/2021 të datës 30.09.2021 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 09.09.2021 të parashtruar nga

ankuesi dhe ka lenë në fuqi Njoftimin me numër 03/1406 të datës 20.08.2021 lidhur me përzgjedhje përfundimtare të kandidatëve.

Pas pranimit të Vendimit KA.nr.51/2021 të datës 30.09.2021 të KZKA/KGJK, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve procedurave të rekrutimit lidhur me pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, me pretendimin ankimor se kandidatja e përzgjedhur _____ nuk i plotëson kushtin e përvojës së punës prej një (1) viti, siç kërkohet në konkurs.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka konstatuar se sipas konkursit të datës 20.05.2021, për pozitën e punës Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, si kritere themelore kanë qenë të përcaktuara:

- *Diplomë universitare: në Fakultetin Juridik; dhe*
- *Një (1) vit përvojë pune profesionale.*

Kolegji, nga analizimi i dosjes së aplikimit të kandidatës së përzgjedhur _____ ka gjetur se e njëjta me datë 13.02.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakulteti Juridik pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Lidhur me përvojën e punës të kandidatës së përzgjedhur, kolegji duke iu referuar Vërtetimit të datës 22.04.2020 ka konstatuar se kandidatja e _____ nga data 20.02.2020 deri me datën 20.04.2020 ka vijuar punën praktike të avokati ndërsa sipas Akt Emërimit të datës 10.06.2020 të KGJK-së është konstatuar se kandidatja e përzgjedhur _____ nga data 08.06.2020 deri me datën 08.06.2021 ka qenë duke vijuar punën praktike në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-dega Vushtrri, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur _____ deri në ditën e aplikimit me datë 03.06.2021, ka me shumë se një (1) vit përvojë pune pas diplomimit, pra e njëjta ka pambushur kriterin e përvojës së punës siç është përcaktuar me konkursin e datës 20.05.2021, për pozitën e punës Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, e në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se është i pa bazuara pretendimi ankimor i ankuesit

Andaj, duke marrë parasysh konstatimin si me lartë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me zhvillimin e kësaj procedurë të rekrutimit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se Komisioni Përzgjedhës për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 1", në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës" si dhe nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë".

Kolegji për Shqyrtim e Ankesave ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve edhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.51/2021 të datës 30.09.2021, vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejte ligjin material, duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.889/2021

Avdyl Bektashi


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

